



REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIJA ZA PROJEKTOVANJE IZ OBLASTI GRAĐEVINARSTVA I POSREDOVANJE U PROMETU NEPOKRETNOSTI	
AGENCIJA ZA PROJEKTOVANJE IZ OBLASTI GRAĐEVINARSTVA I POSREDOVANJE U PROMETU NEPOKRETNOSTI	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. lista Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-3712/12
Data Datum Dat.	16.10.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJAKOVË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U ĐAKOVICI/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN GJAKOVË

Nr.regj.04-262/2012

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËRVAJTJE NE GJAKOVE, me Kryetaren Drita Bunjaku duke vendosur ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurës Teuta Serhati nga GJakovë, per shkak te vepres kundervajttese nga neni 6,7,16.1.1 e 1.2 te Ligjit per deklarimin, perjardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publik, Nr.03/L-151 te Kosoves,dhe nenit 10,73,74,195 te Ligjit mbi kundervajtjet, me date 28.09.2012 merr kete:

A K T V E N D I M

E pandehura Teuta Zenel Serhati, mjeke, e lindur me 15.12.1960 në Gjakovë, Rr.N.Tereza nr.499.

Ë S H T Ë P E R G J E G J E S

Per shkak se me 18.05.2012 e pandehura Teuta si zyrtare e larte publike nuk ka deklarue gjendjen e pasuris se saj, ne Drejtorin e agjensionit kunder korrupsion qe ka qene i detyruar qe ta beje gjere me 31 Mars te qdo viti, dhe ta deklaroi pasurin e saj ne Agjensionin kunder korrupsion.

Me qka ka bere veper kundervajttese nga neni 6,7,16.1.1 e 1.2 te Ligjit per deklarimin, perjardhjen dhe kontrollin e pasuris dhe te dhuratave te zyrtarve te larte publik, Nr.03/L-151, me aplikimin e dispozitave te larte permendura,

I S H Q I P T O H E T

Q O R T I M

A r s y e t i m

Sipas kerkeses te Agjensis kunder korrupsionit në Prishtine, nr.01-1809/2012 date 18.05.2012 kunder te pandehures eshte inicuar procedura per shkelje te pershkruar si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

Ne proceduren kundervajttese e pandehura ne deklaraten e dhene pranë kesaj Gjykate, deklararon se formularin për deklarimin e perjardhjen dhe gjendjes se pasuris unë nuk e kame marre me kohe dhe lidhur me faktin se si kryeshefe e Departamentit te diagnostifikimit në spitalin e Gjakovës, nuk kame qenë në dijeni për këtë obligim. Në momentin që jam njoftue se është bërë kerkese për fillimin e procedures kundervajttese ndaj meje për mos deklarim te pasuris me 15.08.2012 kam shkue në Agjension kame prezentue formularin dhe vertetimin lidhur me kete ia prezentoj Gjykates.

Gjyqtarja shqyrtoi thenjet e cekura ne kerkese nga Agjensia kunder korrupsionit në Prishtin, deklaraten e te pandehures, faktin se e paraqitura ka prezentuar vertetim nga Agjensioni kunder korrupsionit te cilen ia bashkangjesim lendes, qka Gjykata i fale besimin pales,e qe ne mase te konsiderueshme zvoglon pergjegjesin e kryesit keshtu qe mund te pritet qe edhe pa dhenjen e denimit e njejta nuk do te perseris kundervajtjen dhe ndaj saj shqiptohet masa ndeshkuese QORTIM.

3-3712/42/02
sluzj

Me rastin e shqiptimit te qortimit gjyqtarja ka marre parasysh rendesin e vepres, pasojat e saj, shkallen e pergjegjesis se te pandehures, sjelljen korrekte ne Gjykate dhe gjendjen ekonomike te saj e te gjitha keto me bindje se masen e dhene do te arrihet qellimi i ndeshkimit.

Per sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

Kunder ketij aktvendimi te pandehures dhe parashtruesi i kerkeses kane te drejte ankese ne afatin brenda 8 ditesh nga dita e marrjes se ketij aktvendimi Gjykates se larte per kundervajtje ne Prishtine.

Ankesa dergohet nepermjet te kesaj Gjykate.

Aktvendimi i dergohet te pandehures dhe parashtruesit te kerkeses.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE GJAKOVE.

Vendosur me 28.09.2012. Nr.regj.04-262/2012

KRYETARJA

Drita Bunjaku

